



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:204564

Datë: 26.01.2021

Numri i dokumentit: 01444806

C.nr.1127/19

GJYKATA THEMELORE NE PEJE, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit Xh. Sh., nga, të cilin e përfaqëson Venera Gashi, avokate në Pejë, kundër te paditurës, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Fisnik Imami, nga Peja, për kompensimin e pagave përcjellëse dhe shpërblimin jubilar, vlera e kontestit: 3.171,06€, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur me dt.19.01.2021, në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, pas së cilës më dt.25.01.2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Xh. Sh., nga

DETYROHET e paditura, që paditësit Xh. Sh., nga, që në emër kompenzimit të tri(3) pagave përcjellëse në pension, në shumë prej 1.585,53€, dhe në emër të kompenzimit të tri(3) pagave bazë për shpërblim jubilar, në shumën prej 1.585,53€, t'ia paguaj shumën totale në lartësi prej 3.171,06€, më kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit dt.25.01.2021, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DETYROHET e paditura, që paditësit Xh. Sh., nga, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 279€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës të tij, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për kompenzimin e pagave përcjellëse në pension dhe shpërblimin jubilar, duke theksuar se paditësi ka qenë mësimdhënës i lëndës së matematikës fillimisht në shkollën teknike, pastaj edhe në gjimnazin „.....” në, mirëpo me aktvendimin nr.2095/104, të dt.27.09.2016, të njëjtit ju ka ndërprerë marrëdhënia e punës sepse i ka plotësuar kushtet ligjore të moshës mandatorë të pensionit që është (65) vjet. Ka cekur se paditësi ka qenë mësimdhënëse në këtë shkollë me shumë se 36 vite, ndërsa nga pasqyra e llogarisë bankare vërtetohet se paditësi, tri(3) pagat e fundit i ka pasur në shumën prej 1.585,53€ (një pagë ka qenë në shumë prej 528.51€), dhe se shpërblimi jubilar i takon në shumë prej 1.585,53€, e në shumë të tërësishëm prej 3.171,06€.

Paditësi përmes shkresës i është drejtuar të paditurës që t'ia paguaj tri(3) paga për përcjellje në pension në shumën prej 1.585,53€, dhe për shpërblimi jubilar në shumën prej 1.585,53€, mirëpo e paditura nëpërmes përgjigjes në kërkesën e paditësit, ka potencuar se nuk mund të aprovoj kërkesën e paditëses për arsye se Ministria e Financave, nuk ka bërë alokimin e mjeteve financiare apo ndonjë grandit të posaçëm për realizimin e kësaj të drejte,

dhe bazuar në planifikim buxhetor komunale një e drejtë e tillë me implikime financiare nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Përveç tjerash ka cekur se paditësit duke u mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshëm Kolektive të Kosovës, dhe Ligjit të Punës nr.03/L-212, dhe fakteve relevante të paraqitura në padi, se paditësit i takon shpërblimi jubilar dhe pagat për përcjellje në pension, andaj e autorizuar e palës paditëse e ka propozuar gjykatës, që pas administrimit të provave ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuar e palës paditëse, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe precizimit të bërë në seancën gjyqësore të dt.19.01.2021, duke potencuar se pas administrimit të provave konsideron se është vërtetuar gjendja faktike, se është i pa kontestueshme fakti se paditësi ka qenë profesor në Gjimnazin e Pejës, më shumë se 36 vite, dhe për këtë arsye i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përpilim të padisë shumën prej 104€, për taksë gjyqësore shumën prej 40€, për përfaqësim në një(1) seancë shumën prej 135€, e në shumën e përgjithshme prej 279€.

E paditura, nëpërmjet të autorizuarës së saj, me përgjigje në padi, të dt.20.07.2020, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, me arsyetim se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, në këtë çështje kontestimore, pasi që paditësja padinë dhe kërkesëpadinë e saj duhet ta drejtoj ndaj Ministrisë së Arsimit(MASHT), Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale(MPMS), dhe Ministrisë së Financave(MF), si garantues të përmbushjes së obligimeve financiare që rrjedhin nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, të dt.18.06.2014, të nënshkruar mes OEA, Aleancës Kosovare të Biznesit, BSPK dhe Qeverisë së Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale dhe nga Kontrata e Kolektive e dt.18.04.2017, për punëtorët e arsimit para universitar të cilën e kanë nënshkruar e MASHT-i dhe SBASHK-u, si një pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Përkatësisht, neni 46 par.2 i Kontratës Kolektive përcakton se, MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht në MF-në për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunitat e Kosovës me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 paragraf 5.7, dhe brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare.

Ka cekur se në asnjërin nga këto dokumente ligjore nuk është nënshkruar e paditura, andaj nuk mund të rrjedhë ndonjë obligimin ligjor nga kërkesëpadia e paditëses. Lidhur me kërkesën për pagesën e pagave jubilarë, ka theksuar se një kërkesë e tillë është e parashkruar, se paditësja e ka humbur afatin ligjor, kjo sepse paga jubilarë rrjedh çdo 10 vjet, kurse afati ligjor për një kërkesë të tillë është 3 vjet, pas kalimit të çdo periudhe dhjetë(10) vjeçare.

Ndërsa se sa i përket shpenzimeve të kërkuara, e ka kundërshtuar një kërkesë të tillë, për arsye se janë krijuar shpenzime të panevojshme në këtë procedure kontestimore, andaj ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata për vërtetimin e plote të gjendjes faktike në këtë çështje juridike – kontestimore, zhvilloj procedurën e provave ku si provë u administruan këto prova: aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me nr.2095/104, të dt.27.09.2016; njoftimi nga Komuna e Pejës me nr.1527/132, i dt.29.08.2019; kërkesa e paditësit drejtuar Kuvendit të Komunës DKA, e dt.06.08.2019; vërtetimi nr.95, i dt.12.04.2019; lista e pagave ku është edhe paga e paditësit e dt.01.09.2016, dt.01.07.2016, dhe dt.01.08.2016, vërtetimi i lëshuar nga DAP (Departamenti i Arsimit Pensional i Republikës së Kosovës) në emër të paditësit, i dt.05.10.2016; librezat e punës me nr.1616/74, si dhe deklaratimet e të aut. të palëve ndërgjyqëse.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurës

Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile, duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, për faktin se:

Nga provat e pa kontestuara është vërtetuar fakti së paditësi Xh. Sh., nga, ka qenë i punësuar pranë të paditurës, në vendin e punës mësimdhënës i lëndësmatematikes fillimisht në shkollën teknike pastaj edhe në gjimnazin „.....” në, gjerë me dt.24.01.2017, kur edhe i ka pushuar marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit për shkak të arritjes së moshës së pensionit.

Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha provave prezent në lëndë dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqësve e duke u mbështetur në Kontratën Kolektive Sektoriale, të marsit të vitit 2015, me dispozitat e nenit 20, përcaktohet se „Benefiti mbi ndërprerjen e kontratës së punës -Të punësuarit për të cilët ka pushuar nevoja e punës, dhe për të cilët nuk ka mundur të caktohet asnjë e drejtë e përcaktuar me Ligjin e Punës dhe Kontratën e Përgjithshme Kolektive, do të gëzojnë të drejtën e kompensimit sipas stazhit të rregullt të punës, në bazë të lartësisë së përcaktuar me Ligjin e Punës dhe Kontratën e Përgjithshme Kolektive”, e në lidhshmëri me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dt.18.03.2014, në mënyrë decidive me nenin 52 paragraf 1, përcaktohet se „I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”. Me paragrafin 2 të kësaj marrëveshje përcaktohet se: „Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, ndërsa në paragrafin 3 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”. Me nenin 53 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se „I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit”, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar, dhe duhet aprovuar.

Andaj gjykata vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, lidhur me kompensimin e tri(3) pagave për përcjellje në pensionim dhe tri(3) pagave për shpërblimin jubilar, të cilat kanë mbështetje në dispozitat ligjore të cekura me lartë, për arsye se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, e dt.18.03.2014, është në fuqi dhe është bazë ligjore që duhet t’i referohemi në këtë çështje juridiko kontestimore. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore në marrëveshjen kolektive janë pajtuar, dhe e kanë shprehur vullnetin e përbashkët që vërtetohen me nënshkrimet e tyre. Gjykata gjen se marrëveshja është dokument i vlefshëm dhe i zbatueshëm në tërë Republikën e Kosovës, fakt i pakontestueshëm sepse marrëveshja është nënshkruar nga autoritetet kompetente, dhe është përcaktuar shprehimisht zbatimi i saj, kush e zbaton dhe ndaj kujt zbatohet, dhe ky obligim duhet të përfundohet sipas marrëveshjes se nënshkruar, për çka gjykata në një situatë të tillë, vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Ndërsa për lartësinë e kërkesëpadiës gjykata gjatë vendosjes pat parasysh që të autorizuarit e palëve ndërgjyqësore një zëri janë pajtuar që mos të caktohet eksperti financiar, për t’iu shmangur shpenzimeve procedurale të pa nevojshme, ashtu që pagat jubilarë dhe pagat për përcjellje në pension të jenë të llogaritura sipas listës së pagave të paditësit, bazuar nga gjendja e llogarisë bankare e paditësit (nga dt.01.01.2016 deri me dt.31.12.2016) në ProCredit Bank, andaj, gjykata ka konstatuar se paditësit i takojnë tri(3) paga përcjellëse në pension sipas mesatares se pagave të fundit dhe atë 528.51€×3, në shumën prej 1.585,53€, dhe për tri(3) shpërblime jubilarë sipas pagës bazë në kontratë, shumën prej 1.585,53€, e në shumën e totale prej 3.171,06€.

Gjithashtu Gjykata, me rastin e vendosjes pati parasysh edhe kundërshtimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, dhe gjatë shqyrtimit kryesor lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe, sepse përgjegjësia siç u cek më lartë, në rastin konkret bie ndaj të paditurës, dhe pretendimi e të autorizuarës së paditurës janë të pa bazuara sepse Ligji për Arsim Komunal, nr.03/L-068, respektivisht nenin 4, shprehimisht citon se „Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me arsimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, nëse mbështetemi në këtë Ligj dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nenin 16 dhe 17 par.1 pika h), atëherë ky obligim bie ndaj te paditurës Komuna e Pejë, për kompensimi e paditësit”.

Kundërshtimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë për pagën jubilarë, për gjykatën nuk ishin me ndikim, për faktin se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dt.03.10.2016, sipas fuqisë ligjore për shkak të mbushjes së moshës mandatorë të pensionit që është (65) vjet, ndërsa paditësi padinë në gjykatë për kompensimin e pagave përcjellëse dhe shpërblimin jubilar e ka parashtruar brenda afatit ligjor tre(3) vjeçar, respektivisht më dt.17.09.2019, andaj gjykata vlerëson së në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës.

Vlen të ceket se kërkesa e paditësit për shpërblimin jubilar e aprovuar nga gjykata gjënë mbështetje në nenin 52, dhe 53, të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, e dt.18.03.2014, e cila ka hyrë në fuqi nga dt.01.01.2015, e në bazë të së cilës këtë kërkesë duhet ta përmbushë punëdhënësi i fundit.

Vendimin lidhur me kamatën e gjykuar, mbështetet ne dispozitat e nenit 382 te Ligjit Nr. 04/L-77-LMD-së, ku gjykata si moment të fillimit te llogaritjes se kamatës e ka pranuar ditën e nxjerrjes se aktgjykimi më dt.25.01.2021, duke i'a njohur paditësit kamatën ligjore prej 8%, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 382 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-77-LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u mbështetur ne dispozitën e nenit 452 par.1, nenit 463.1 të LPK-së, e sipas tarifës se OAK-ës, në këto shpenzime janë llogaritur: taksa gjyqësore në shumë prej 40€, përpilimin i padisë në shumë prej 104€, dhe për përfaqësim në një(1) seancë të mbajtura në shumë prej 135€, e në shumën totale prej 279€.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.1127/19, me dt.25.01.2021.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.